

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ndihmoi me informacione sekrete Agasin/ GJKKO lë në 'arrest shtëpiak' Vlorë Hysenin! Burg për Embro Sulejmanin dhe Fatjon Kalluçin. Njëri i çoi biznesmenit ekspertizën e makinës e tjetri ushqime
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/njeri-i-coi-agasit-ekspertizen-e-makines-e-tjetri-i-conte-ushqime-g-i515783
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	24 shtator 2026, 10:03:08 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	24 shtator 2026, 09:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1fe14a0700d708a0bc18bc028cfc66d0d49931874ddda47b66cbeaa89eef2461
TEKSTI	ec01af2f3cd5dc2dc8f4e18439b8e322199f886cd57aeb626d21d734b57b6b91
PAMJA	04ed0512b6938b370a3c7747265fa74f38a683f2e9c26352aaa99dfec8299aec

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	d56b2868b32b26974acf401361938cffadce15525681f5ee21278a53c74e2dfd
E MËPARSHMJA	194ea29b919367c7974fb385974502f1a3c5f27f4e3a70840097ef37e9c8031c
RRËNJA MERKLE	de40688aef4c4ba129d7a84fd77d2b1b27a16260a8d1d580a5a1a060453e9f69
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/d56b2868b32b26974acf401361938cffadce15525681f5ee21278a53c74e2dfd

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

4 ORE ME PARE

Dita e 117-të e protestës/ Qytetarët zbrasin sërish në shesh, kërkohet dorëheqja e kryeministrit Rama: Ju erdhi fundi!

7 ORE ME PARE

Vlora Hyseni sulmon Klodiana Lalën para GJKKO-së, gazetarja: Shantazh. AGSH: Të tërheqë deklaratat (REAGIMET)

7 ORE ME PARE

Skandali SHISH/ Vlora Hyseni vë në rrezik vendin për Ergys Agasin: Të gjithë radarët e shtetit i mbyll për ty

10 ORE ME PARE

Ndihmoi me informacione sekrete Agasin/ GJKKO lë në 'arrest shtëpiak' Vlora Hysenin! Burg për Embro Sulejmanin dhe Fatjon Kalluçin. Njëri i çoi biznesmenit ekspertizën e makinës e tjetri ushqime

LIVE UPDATES

Ndihmoi me informacione sekrete Agasin/ GJKKO lë në 'arrest shtëpiak' Vlora Hysenin! Burg për Embro Sulejmanin dhe Fatjon Kalluçin. Njëri i çoi biznesmenit ekspertizën e makinës e tjetri ushqime

• Gjykata e Posaçme ka lënë në fuqi masën e sigurisë "arrest shtëpie" për ish-drejtoreshën e Shërbimit Informativ Shtetëror, Vlora Hyseni. • Pas përfundimit të seancës gjyqësore, Hyseni u largua nga ambientet e GJKKO-së pa dhënë asnjë deklaratë për mediat. • Hyseni akuzohet për "nxjerrje të sekretit shtetëror" dhe "përkrahje të autorit të krimit". • Katër ditë para se ti komunikohet masa e sigurisë "arrest në shtëpi", Hyseni ishte pyetur në Prokurorinë e Posaçme si person në dijeni për lidhjet me Ergys Agasin, biznesmenin e arrestuar më 26 gusht për aferën e AKSHI-t. • Ajo kishte pranuar kontaktet me Agasin, duke thënë se qëllimi ka qenë për shkak të detyrës së saj, por mesazhet tregojnë të kundërtën që thotë ish-kreu i SHISH. • Por, gjatë kontrolleve të 22 korrikut në "Equos Resort", SPAK kishte gjetur 9 faqe dokumente të dyshuara të dhëna sekrete shtetërore dhe qindra komunikime të Hysenit me Agasin. • Gjatë një seanca vetë Agasi kishte pranuar se i kishte lënë dokumentat në makinë me qëllim që t'i gjente SPAK. • Nga komunikimet e zbuluara në celular të Agasit dhe Vlora Hysenit, nga fundi i qershorit deri më 26 gusht kur ai u arrestua në Durrës, tregojnë një lidhje shumë më të afërt, ndryshe nga ata që thonë "bashkëpunëtor". • Ndërkohë, pak më herët GJKKO ka dhënë masën e sigurisë për Fatjon Kalluçin, shef në Laboratorin Shkencor të Policisë, dhe Embro Sulejmanin, kryekamerier në lokalin e vilave qeveritare në Durrës, të cilët akuzohen nga SPAK se ndihmuan Ergys Agasin gjatë arratisë. • Ndaj Kalluçit rëndon vepra penale e zbulimit të të dhënave sekerete te grupet kriminale. • Ai dyshohet se i ka dërguar Ergys Agasit në muajin gusht, para se të arrestohej, 3 foto të ekspertizës së makinës Land Rover Defender në pronësi të tij, që u sekuestrua gjatë kontrolleve në Equos Resort. • Gjatë seancës, Kalluçi është shprehur se nuk mban mend gjë të ketë dërguar akte sekrete siç e dyshon SPAK. • Ndërsa, kryekamerieri Embro Sulejmani i akuzuar për përkrahje të autorit të krimit, i dërgonte Ergys Agasit ushqime në banesën ku qëndronte i fshehur. • Në seancë, Sulejmani ka deklaruar se e njej Ergys Agasin, sepse janë të dy nga Durrësi.

6 artikuj për këtë temë.

8 ORE ME PARE

Përfundon seanca në GJKKO për masën e sigurisë, Vlora Hyseni del nga gjykata, 'kyç' gojën për mediat



editoriale

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Irena Beqiraj

Kostot e jetesës edhe lajmi se ekonomia po ecën mirë

Në vëmendje



Viora Hyseni

TIRANË- Gjykata e Posaçme ka lënë në fuqi masën e sigurisë “arrest shtëpie” për ish-drejtoreshën e Shërbimit Informativ Shtetëror, Viora Hyseni. Pas përfundimit të seancës gjyqësore, Hyseni u largua nga ambientet e GJKKO-së pa dhënë asnjë deklaratë për mediat.

Hyseni akuzohet për “nxjerrje të sekretit shtetëror” dhe “përkrahje të autorit të krimit”. Katër ditë para se ti komunikohet masa e sigurisë “arrest në shtëpi”, Hyseni ishte pyetur në Prokurorinë e Posaçme si person në dijeni për lidhjet me Ergys Agasin, biznesmenin e arrestuar më 26 gusht për aferën e AKSHI-t.

Ajo kishte pranuar kontaktet me Agasin, duke thënë se qëllimi ka qenë për shkak të detyrës së saj, por mesazhet tregojnë të kundërtën që thotë ish-kreu i SHISH. Por, gjatë kontrolleve të 22 korrikut në “Equos Resort”, SPAK kishte gjetur 9 faqe dokumente të dyshuara të dhëna sekrete shtetërore dhe qindra komunikime të Hysenit me Agasin.

Gjatë një seanca vetë Agasi kishte pranuar se i kishte lënë dokumentat në makinë qëllim që t'i gjente SPAK. Nga komunikimet e zbuluara në celular të Agasit dhe Viora Hysenit, nga fundi i qershorit deri më 26 gusht kur ai u arrestua në Durrës, tregojnë një lidhje shumë më të afërt, ndryshe nga ata që thonë “bashkëpunëtor”./Dosja.al

10 ORE ME PARE

Pritet t’i komunikohet masa, Viora Hyseni mbërrin në GJKKO



Viora Hyseni

TIRANË- Ish-drejtoresha e SHISH, Viora Hyseni ka mbërritur në ambientet e GJKKO, për t’iu kominukuar dhe shqyrtuar masa e sigurisë. Hyseni akuzohet për “nxjerrje të sekretit shtetëror” dhe “përkrahje të autorit të krimit”.

Katër ditë para se ti komunikohet masa e sigurisë “arrest në shtëpi”, Hyseni ishte pyetur në Prokurorinë e Posaçme si person në dijeni për lidhjet me Ergys Agasin, biznesmenin e arrestuar më 26 gusht për aferën e AKSHI-t. Ajo kishte pranuar kontaktet me Agasin, duke thënë se qëllimi ka qenë për shkak të detyrës së saj, por mesazhet tregojnë të kundërtën që thotë ish-kreu i SHISH.

Por, gjatë kontrolleve të 22 korrikut në “Equos Resort”, SPAK kishte gjetur 9 faqe dokumente të dyshuara të dhëna sekrete shtetërore dhe qindra komunikime të Hysenit me Agasin. Gjatë një seanca edhe vetë Agasi kishte pranuar se i kishte lënë dokumentat në makinë qëllim që t'i gjente SPAK.

Nga komunikimet e zbuluara në celular të Agasit dhe Viora Hysenit, nga fundi i qershorit deri më 26 gusht kur ai u arrestua në Durrës, tregojnë një lidhje shumë më të afërt, ndryshe nga ata që thonë “bashkëpunëtor”.

Pak më herët GJKKO dha masat e sigurisë edhe për Fatjon Kalluçin, shef në Laboratorin Shkencor të Policisë dhe Embro Sulejmanin, kryekamerier në lokalitë e vilave qeveritare në Durrës, të cilët akuzohen nga SPAK se ndihmuan Ergys Agasin gjatë arratisë.

AKTUALITET 24 SHTATOR 2026, 22:05

Viora Hyseni 'rrëmben' vëmendjen e mediave ndërkombëtare/ L'Exppress: Një sfidë e re për qeverinë e Edi Ramës

AKTUALITET 24 SHTATOR 2026, 21:48

Kush ia dërgoi Agasit aktin e ekspertimit të kriminalistikës për gjurmë gishti, fije floku dhe...

AKTUALITET 24 SHTATOR 2026, 12:48

Shkoi në GJKKO për tu njohur me masën e sigurisë/ Momenti kur ish-drejtoresha e SHISH i kthehet gazetares: Si kalon ti me agjentët serbë në hotel (VIDEO)

më të klikuarat

Atentati ndaj vëllait të Fabio Dushkut/ Aksioni i policisë greke, arrestohen 3 shqiptarë dhe shpallet në kërkim Daniel Dushku

“Krejt radarët e shtetit i mbyll për ty?” Deklarata të forta dashurie nga Viora Hyseni për Ergys Agasin: Të du!

Shkoi në GJKKO për tu njohur me masën e sigurisë/ Momenti kur ish-drejtoresha e SHISH i kthehet gazetares: Si kalon ti me agjentët serbë në hotel (VIDEO)

Dosja e SPAK/ Agasi mori të dhëna në telefonat e “zberthyer” nga policia! Iu vunë në dispozicion nga përgjegjësi i Sektorit në Policinë Shkencore

insights

Rezarta Gagani
Dëshallë sallatit tim

Ndaj Kalluçit rendon vepra penale e zbulimit të të dhenave sekerete të grupet kriminale. Ai dyshohet se i ka dërguar Ergys Agasit në muajin gusht, para se të arrestohej, 3 foto të ekspertizës së makinës Land Rover Defender në pronësi të tij, që u sekuestrua gjatë kontrolleve në Equos Resort.

Gjatë seancës, Kalluçi është shprehur se nuk mban mend gjë të ketë dërguar akte sekerete siç e dyshon SPAK. Ndërsa, kryekamerieri Embro Sulejmani i akuzuar për përkrahje të autorit të krimit, i dërgonte Ergys Agasit ushqime në banesën ku qëndronte i fshehur. Në seancë, Sulejmani ka deklaruar se e nje Ergys Agasin, sepse janë të dy nga Durrësi./Dosja.al

11 ORE ME PARE

Zbardhet dëshmia, ja çfarë deklaruan para GJKKO Embro Sulejmani dhe Fatjon Kalluçi: I çova ushqim, çfarë krimi kam bërë?



Embro Sulejmani dhe Fatjon Kalluçi

TIRANË- Gjykata ka dhënë masën e sigurisë për Embro Sulejmanin dhe Fatjon Kalluçin në lidhje me skandalin e SHISH. Sulejmani ka deklaruar se e nje Ergys Agasin, sepse janë të dy nga Durrësi.

"Nuk e di çfarë krimi kam bërë unë, që i kam çuar supë e ushqim".

Ndërsa oficeri i policisë shkencore Kalluçi ka pohuar se nuk mban mend që të ketë dërguar akte sekerete Agasit, ashtu siç e akuzon SPAK.

Gjykata e Posaçme la në burg përgjegjësin e Policisë Shkencore, Fatjon Kalluçi dhe Embro Sulejmanin. Ata akuzohen për "veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës" dhe "përkrahje të autorit të krimit", për dosjen ndaj Ergys Agasit. Në orën 12:00, drejtuesja e shkarkuar e Shërbimit Informativ të Shtetit Vora Hyseni pritet të ulet në bankën e të akuzuarve, në një seancë gjyqësore të marrjes në pyetje, gjatë së cilës gjykata verifikon masat e sigurisë "arrest në shtëpi" dhe "pezullim nga detyra" të dhëna në mungesë ndaj saj, si e dyshuar për "përkrahje të autorit të krimit" dhe "nxjerrje të sekretit shtetëror"/Dosja.al

11 ORE ME PARE

Skandali me SHISH/ Lihen në arrest me burg Embro Sulejmani dhe Fatjon Kalluçi



Aleksi Gjoni po ndërtohet një pallat

Auron Janku

Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Ola Xama

Republika e 1 euroshit ku Rama zgjedh kush bëhet biznesmen

Idriz Konjari

Sa gati është biznesi shqiptar për tu përshtatur me tregun e BE-së?

Moti

Powered by tomorrow

TIRANË- Gjykata ka dhënë masën e sigurisë për Embro Sulejmanin dhe Fatjon Kalluçin në lidhje me skandalin e SHISH. Ndaj të dyve është caktuar masa e sigurisë "arrest në burg".

Sulejmani ka deklaruar se e njeh Ergys Agasin, sepse janë të dy nga Durrësi.

"Nuk e di çfarë krimi kam bërë, i kam çuar supë e ushqim", mësohet të ketë thënë ai.

Ndërsa Kalluçi është shprehur se nuk mban mend gjë të ketë dërguar akte sekrete siç e dyshon SPAK.

13 ORE ME PARE

Ndihmuan Ergys Agasin gjatë arratisë, nis masa në GJKKO për Fatjon Kalluçin dhe Embro Sulejmanin



Gjykata e Posaçme

TIRANË- Në Gjykatën e Posaçme ka nisur seanca për verifikimin e masës së sigurisë dhe marrjen në pyetje ndaj Fatjon Kalluçit dhe Embro Sulejmanit, të arrestuar në kuadër të një procedimi që ka të bëjë me përkrahjen e Ergys Agasit në kohën kur ai ishte në kërkim.

Sipas të dhënave të bëra publike në kuadër të hetimit, Fatjon Kalluci, në detyrën e shefit të Policisë Shkencore, dyshohet se në muajin gusht, përpara arrestimit të Agasit, i ka dërguar atij tre foto të ekspertizës së automjetit tip "Land Rover Defender", me targë GG44AA, i cili ishte gjetur në "Equos Resort".

Ndërkohë, sipas hetimeve Embro Sulejmani, kryekamariery dyshohet se i dërgonte ushqime në banesën ku qëndronte i fshehur Ergys Agasi. Këto të dhëna mësohet se janë zbuluar në telefonin e Agasit. Mbrojtja pritet t'i kërkojë gjykatës shpalljen e moskompetencës, ndërsa avokatët do të kërkojnë kohë për tu njohur me aktet e dosjes.

Ndërkohë, në orën 12:00 pritet të zhvillohet edhe seanca për ish-drejtoreshën e SHISH, Vlora Hyseni. Katër ditë para se ti komunikohet masa e sigurisë "arrest në shtëpi", Hyseni ishte pyetur në Prokurorinë e Posaçme si person në dijeni për lidhjet me Ergys Agasin, biznesmenin e arrestuar më 26 gusht për aferën e AKSHI-t. Ajo kishte pranuar kontaktet me Agasin, duke thënë se qëllimi ka qenë për shkak të detyrës së saj, por mesazhet tregojnë të kundërtën që thotë ish-kreu i SHISH.

Por, gjatë kontrolleve të 22 korrikut në "Equos Resort", SPAK kishte gjetur 9 faqe dokumente të dyshuara të dhëna sekrete shtetërore dhe qindra komunikime të Hysenit me Agasin. Gjatë një seance edhe vetë Agasi kishte pranuar se i kishte lënë dokumentat në makinë qëllim që t'i gjente SPAK. Nga komunikimet e zbuluara në celular të Agasit dhe Vlora Hysenit, nga fundi i qershorit deri më 26 gusht kur ai u arrestua në Durrës, tregojnë një lidhje shumë më të afërt, ndryshe nga ata që thonë "bashkëpunëtor"./Dosja.al

14 ORE ME PARE

I dha Ergys Agasit informacione sekrete/ Dalin sot para GJKKO ish-drejtoresha e SHISH dhe Fatjon Kalluci e Embro Sulejmani



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.